



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL (i përmbledhur)¹

Tiranë, më 28.12.2020, ora 10:00

Drejton mbledhjen -
Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Shpallja e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve në vendin vakant në gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.
2. Miratimi i ekspertit për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhës së huaj (atë angleze), të deklaruar nga kandidati i lejuar për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese.
3. Ndërprerje e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve në vendin vakant në gjykatën Kushtetuese për kandidatin e lejuar
- Altin Binaj
4. Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës së kandidatëve të lejuar:
- Sonila Bejtja.
5. Zhvillimi i intervistës me kandidatët e lejuar për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, si më poshtë:
- Sonila Bejtja.
6. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja për kandidatët e lejuar.
7. Diskutimi dhe miratimi i listës përfundimtare të renditjes, si dhe i raportit përkatës.

Marrin pjesë :

- | | | |
|----|------------------|--------------|
| 1. | Vitore Tusha | (zv/kryetar) |
| 2. | Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. | Arta Marku | (anëtare) |
| 4. | Miranda Andoni | (anëtare) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

5. Saida Dollani (anëtare)
6. Fatjona Memçaj (anëtare)

Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm:

1. **Erinda Ballanca, Avokat i Popullit.**

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Bledar Dervishaj**, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës.

HAPET MBLEDHJA

Vitore Tusha hap mbledhjen dhe bën me dije rendin e ditës. Njofton se mbledhja është thirrur brenda afatit 5-ditor nga përfundimi i procedurës së verifikimit, e parashikuar në nenin 239, paragrafi 1, të ligjit 115/2016, si dhe rendi i ditës është publikuar në përputhje me procedurat dhe aktet e miratuara nga Këshilli.

Verikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje.

Bën me dije se mungon anëtari Ludovik Dodaj, për arsye shëndetësore.

Fton anëtarët të miratojnë rendin e ditës.

Anëtarët miratojnë rendin e ditës.

Erinda Ballanca shprehet dakord.

Bledar Dervishaj nuk ka koment.

Vitore Tusha vazhdon me pikën e parë të rendit të ditës që lidhet me shpalljen e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatit në vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019. Lidhur me përcaktimin e kësaj çështjeje në rendin e ditës, thekson se relatorja e ka njoftuar dhe i ka përcjellë informacionin se ka përfunduar procedura e vlerësimit të kandidatëve për vakancën në fjalë. Relatorja ka përcjellë informacionin me shkrim, i cili i është dërguar edhe anëtarëve dhe në përputhje me nenin 239/1 të ligjit nr. 115/2016 është thirrur mbledhja.

I jep fjalën relatores zonja Miranda Andoni.

Miranda Andoni vijon me relacionin përkatës me cilësinë e relatores për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019: “Për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës, datë 22.11.2019 kanë shprehur interes dhe janë kryer procedurat e verifikimit për dhjetë kandidatë. Konkretisht: 1. Altin Binaj, 2. Artan Spahiu, 3. Dedë Kasneci, 4. Eugen Papandile, 5. Gentian Mete, 6. Sergio Mazreku, 7. Sinan Tafaj, 8. Sonila Bejtja, 9. Shaqir Hasanaj dhe 10. Zhaklina Peto. Kam vlerësuar që për të gjithë kandidatët ka përfunduar procedura e verifikimit të kandidatëve për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019. Konkretisht, për kandidatin Altin Binaj, me vendimin nr. 25, datë 16.09.2020, KED-ja ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Altin Binaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019 (vendim i paankimuar). Për kandidatin Artan Spahiu, me vendimin nr. 26, datë 16.09.2020, KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidatit Artan Spahiu për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019 (vendim i paankimuar). Për kandidati Dedë Kasneci, me vendimin nr. 24, datë 16.09.2020, KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019 (vendim i paankimuar). Për kandidatin Eugen Papandile, me vendimin nr. 35, datë

05.10.2020, KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidatit Eugen Papandile. Kundër këtij vendimi është bërë ankim nga kandidati. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 91, datë 06.11.2020, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 35, datë 05.10.2020 të KED-së. Me vendimin nr. 36, datë 23.11.2020 KED-ja përsëri ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidatit Eugen Papandile. Kandidati ka paraqitur përsëri ankim. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 99, datë 02.12.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë të këtij kandidati. Në lidhje me kandidatin Sergjio Mazreku, me vendimin nr. 32, datë 05.10.2020, KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidatit Sergjio Mazreku. Pasi është paraqitur ankim nga kandidati Serxho Mazreku, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 83, datë 21.10.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Për kandidatin Sinan Tafaj, me vendimin nr. 30, datë 05.10.2020, KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidatit Sinan Tafaj. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga kandidati dhe Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 90, datë 06.10.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Për kandidaten Sonila Bejtja, me vendimin nr. 34, datë 09.10.2020, KED-ja ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatit Sonila Bejtja për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës. Për kandidatin Shaqir Hasanaj, me vendimin nr.31, datë 05.10.2020, është vendosur ndalimi i kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019. Kundër këtij vendimi kandidati ka paraqitur ankim. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 95, datë 10.11.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë. Në lidhje me kandidaten Zhaklina Peto, me vendimin nr. 33, datë 05.10.2020, KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim dhe Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 94, datë 10.11.2020, ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të padisë së paditëses. Shfuqizimin e vendimit nr. 33, datë 05.10.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”. Me vendimin nr. 37, datë 23.11.2020 KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto. Kundër këtij vendimi kandidatja ka paraqitur padi dhe Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 100, datë 07.12.2020, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Shfuqizimin e vendimit nr. 37, datë 23.11.2020. Pasi është marrë për shqyrtim përsëri kjo kandidaturë, me vendimin nr. 61, datë 23.12.2020, KED-ja ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të znj. Zhaklina Peto. Në lidhje me kandidatin Gentian Mete, në kushtet që është paraqitur tërheqja nga kandidimi, KED-ja, me vendimin nr. 27, datë 16.09.2020, ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit dhe pikëzimit. Duke e vlerësuar si të përfunduar procedurën e verifikimit të kandidaturave që sapo cituam, bazuar në paragrafin 38 të vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED-së, së bashku me njoftimin e përfundimit të procedurave të verifikimit për kandidatët për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti në datën 22.11.2019, kam paraqitur edhe relacionet përkatëse për dy kandidatët e lejuar dhe pikërisht për kandidaten Sonila Bejtja dhe kandidatin Altin Binaj”.

Vitore Tusha ndërhyr dhe pyet nëse nga verifikimet e bëra që prej datës 23 e deri në atë moment ka ndonjë komunikim të kandidatës Zhaklina Peto me Këshillin, qoftë me *e-mail*, apo me rrugë postare në sekretari, në lidhje me pretendimet e saj për vendimmarrjen e Këshillit.

Miranda Andoni përgjigjet se nga momenti që është shpallur vendimi për kandidaten Zhaklina Peto, nga verifikimet e fundit nuk konstatohet të ketë komunikim, as nëpërmjet rrugës elektronike, as nëpërmjet rrugës postare, as në ndonjë mënyrë tjetër komunikimi të pranuar nga vetë kandidatja në fillimin e kësaj vakance.

Vitore Tusha i jep fjalën Avokatit të Popullit.

Erinda Ballanca merr fjalën: “Për ta qartësuar pas njoftimit, komunikimit të fundit që ju zonja relatore i keni bërë paraditen e datës 23, nuk ka pasur asnjë komunikim. Sepse, e pyes se ju thatë nga momenti i vendimmarrjes, dhe vendimmarrja ka qenë 7-8 orë më vonë sesa komunikimi i fundit. Pra, për ta saktësuar. Konfirmon që nuk ka pasur asnjë komunikim, të asnjë lloji nga zonja Peto, përveç që në momentin që ju i keni dërguar komunikimin tuaj në datën e zhvillimit të mbledhjes në orën 11.”.

Miranda Andoni sqaron se nga momenti që i është komunikuar vendimi, nuk ka pasur asnjë komunikim me kandidaten në asnjë nga format që kjo kandidatë ka pranuar në deklaratën e saj.

Vitore Tusha pyet nëse ka pasur komunikim para njoftimit të vendimit.

Miranda Andoni sqaron se nga ky moment, që nga komunikimi i fundit përpara se të merrej vendimi për këtë kandidatë, nuk ka asnjë komunikim me kandidaten në asnjë nga format që kandidatja ka pranuar të ketë me KED-në.

Vitore Tusha fton anëtarët të miratojnë projektvendimin që është përgatitur për shpalljen e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve në vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

Anëtarët miratojnë projektvendimin përkatës.

Vitore Tusha vijon me pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin e ekspertit për vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhës së huaj (atë angleze), të deklaruar nga kandidati i lejuar për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese.

Miranda Andoni merr fjalën dhe thekson se nisur nga veprimet e kryera gjatë fazës përgatitore konstatohet, nga komunikimi me kandidaten, se ajo ka pranuar të intervistohet në dy gjuhë të huaja, në gjuhën italiane dhe në gjuhën e angleze. Duke qenë se kandidatja ka kryer studimet edhe në shkollë të mesme, edhe në shkollë të lartë në gjuhën italiane, me pëlqimin e kandidatës, është thirrur një eksperte e gjuhës angleze për kryerjen e intervistës për këtë kandidatë. Propozim i cili i është dhënë kryetares.

Vitore Tusha bën me dije se duke qenë se fakultetet kanë filluar pushimet, u vlerësua të thirret si eksperte përkthyesja zyrtare e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, zonja Adelina Albrahimi. Këshilli edhe më parë, edhe gjatë këtij viti, në përkthimin e disa akteve zyrtare që i janë dashur gjatë komunikimit me Komisionin e Venecies, e ka thirrur si eksperte. Mbi këtë propozim është përgatitur projektvendimi për miratimin si eksperte të znj. Adelina Albrahimi. Pyet anëtarët nëse kanë sugjerime.

Miranda Andoni vë në dukje se është edhe pjesë e listës. Përkthyesja zyrtare për vitin 2020.

Vitore Tusha thekson se është pjesë e listës të Ministrisë së Drejtësisë.

Fatjona Memçaj sqaron se edhe vjet ka shërbyer si eksperte në procedurat e KED-së, për intervistimin e kandidatëve.

Anëtarët miratojnë projektvendimin për ekspertin.

Vitore Tusha vijon me pikën e tretë të rendit të ditës së përcaktuar, ndërprerjen e procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese për kandidatin e lejuar Altin Binaj. Bën me dije se zoti Binaj është emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, ka bërë betimin dhe ka filluar detyrën. Po ashtu, ai është tërhequr edhe nga konkurrimi për vakancën tjetër.

I jep fjalën relatores që të vijojë me relatimin.

Miranda Andoni relaton në mënyrë të përmbledhur relacionin për këtë kandidat: “Është lejuar kandidimi i tij për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti në datën 22.11.2019. Ndërkohë ky kandidat ka shprehur interes edhe për vakancat e tjera për të cilat është lejuar. Gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes është konstatuar se, me vendimin nr. 77 të vitit 2020, Kuvendi i Republikës së

Shqipërisë ka vendosur që zoti Binaj të zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Në datën 22.12.2020 zoti Binaj ka kryer betimin përpara Presidentit të Republikës. Gjithashtu, në datën 22.12.2020, vetë kandidati ka paraqitur një deklaratë ku heq dorë nga kandidimi për vakancën si anëtar i Gjykatës Kushtetuese të shpallur nga Presidenti në datën 22.11.2019”.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje nga anëtarët dhe të ftuarit.

Anëtarët dhe të ftuarit nuk kanë pyetje.

Vitore Tusha fton relatoren të vijojë me relatimin për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës për kandidaten Sonila Bejtja.

Miranda Andoni lexon relacionin përkatës për kandidaten Sonila Bejtja. Relacioni i është bërë me dije edhe kandidatës, e cila është njohur me të.

Anëtarët dhe të ftuarit nuk kanë pyetje.

Vitore Tusha vijon me pikën 5 të rendit të ditës, që lidhet me zhvillimin e intervistës së kandidatës së lejuar për vendin vakant të Gjykatës Kushtetuese, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.

Fton kandidaten dhe ekspertin e gjuhës angleze e miratuar nga Këshilli, e njohur zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, znj. Adelina Albrahimi.

Sqaron ekspertin se do të zhvillohet paraprakisht procedura e betimit dhe e njeh me qëllimet e kësaj ekspertize, që kanë të bëjnë me nivelin e njohjes dhe zotërimit të gjuhës angleze të znj. Bejtja dhe se duhet të mbahen parasysh rregullat bazë të komunikimit procedural, si dhe detyrimin për përgatitjen e raportit që duhet të i përcjellë Këshillit.

Lexohet formula e betimit: “I vetëdijshëm për përgjegjësinë morale dhe ligjore për detyrën që marr përsipër, do ta kryej bazuar në standardet profesionale, me ndershmëri e drejtësi dhe do të ruaj konfidencialitetin për të gjitha të dhënat që lidhen me ekspertimin.”.

Ekspertja Adelina Albrahimi betohet.

Vitore Tusha thekson të vijohet me intervistën e znj. Sonila Bejtja dhe me pas ekspertja do të ndërhyjë duke i adresuar pyetje që ajo mendon për të realizuar qëllimet e raportit të saj.

Fton kandidaten të shpalosni para Këshillit platformën e sa dhe më pas anëtarët e Këshillit të kenë mundësi për të drejtuar pyetje.

Kandidatja Sonila Bejtja paraqet platformën e përgatitur me shkrim, e cila pasi lexohet, depozitohet në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, duke u bërë pjesë e dosjes së kandidatit.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje.

Fiona Papajorgji merr fjalën: “Sipas këndvështrimit tuaj, cilat do të jenë sfidat në Gjykatën Kushtetuese nisur nga fakti që ajo tashmë do të funksionojë pas shumë kohësh?”.

Sonila Bejtja merr fjalën: “Sfidat janë të shumta, sfida kryesore është se Gjykata Kushtetuese duhet të tregojë vërtet që është e paanshme dhe profesionale. Unë mendoj se kjo është parësorja. Kjo për të krijuar vërtet idenë të publiku që më në fund gjykata po ngrihet dhe është ashtu siç duhet të jetë, sepse shikoj shumë skepticizëm në shoqërinë tonë. Dhe unë mendoj se këtu duhet të luftojmë. Sfida e dytë është shpejtësia në shqyrtimin e çështjeve, sepse, me sa di, janë mbledhur goxha çështje, disa prej të cilave janë të nxehta dhe prandaj paanësia është shumë e rëndësishme në zgjidhjen e tyre. Mendoj dhe një lloj *P.R.* i gjykatës që për mua është e rëndësishme e shikoj dhe këtë pjesë pak a shumë jo se nuk e ka, por mund të shikohet se çfarë mund të bëhet dhe më mirë në *P.R.* e gjykatës. Sepse *P.R.* gjykatash është një faktor goxha i rëndësishëm në vendet e zhvilluara dhe duhet implementuar edhe këtu. Këto mendoj se janë sfidat kryesore, shpejtësia në shqyrtim, profesionalizmi dhe krijimi i besimit të të gjithë aktorët edhe të partnerët ndërkombëtarë që vërtet tashmë kemi një gjykatë të paanshme që është rojtaria e Kushtetutës.”.

Miranda Andoni ndërhyt dhe shprehet se duke qenë në cilësinë e relatores, duke njohur në tërësi të gjithë dokumentacionin, duke filluar me jetëshkrimin, motivimin për kandidimin, dokumentet që ndodhen në dosje konstaton se e gjithë karriera profesionale është fokusuar në pjesën më të madhe të saj në fushën tregtare dhe më pak në fusha të tjera. Pyet nëse kandidatja ka ndonjë përvojë apo kontribut në fushën e drejtës kushtetuese dhe në fushën e drejtave të njeriut.

Sonila Bejtja përgjigjet: “Jo vetëm në tregtare janë disa fusha, por edhe tek si të thuash e drejta tregtare brenda përfshihen të drejta kushtetuese që janë respektuar e megjithatë gjatë periudhës që kam ushtruar profesionin e noteres jam marrë edhe me çështje delikate, siç janë zgjidhjet e marrëdhëniet martesore nëpërmjet hartimit të marrëveshjeve për zgjidhjet martesore ku rol të veçantë kanë pasur dhe të drejtat e minorëve, në rastin e dy prindërve duke e praktikuar në mënyre shume rigoroze të drejtat e tyre dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve, kjo duke u bazuar gjithmonë në dispozitat kushtetuese dhe faktikisht nuk dua t’ju provoj mungesë modestie, por nuk është se ndonjë marrëveshje deri tani është ankimuar në gjykata, por ka pasur probleme, domethënë janë zgjidhur shumë butë të gjitha këto lloj mosmarrëveshjes dhe janë respektuar të drejtat e minorenëve që për mua janë shume të rëndësishme dhe jo vetëm zgjidhjet e mosmarrëveshjeve për zgjidhjen e martesave, por edhe në ato deklaratat e thjeshta të deklaratave të udhëtimeve janë shume të rëndësishme, sepse pjesa më e madhe e emigracionit të minorenëve mund të them se janë shkaktuar edhe nga parregullsitë e deklaratave dhe nga mungesa e moskorrektesës së noterit përkarshi firmës së prindërve kemi pasur plot raste të rrëmbimit të minorenëve nga njeri prind. Unë jam munduar që të respektoj vullnetin e dy prindërve dhe të drejtën e fëmijës për udhëtime për shkollim. Po në vitin 2018 jemi paraqitur në një komision ligjesh ne si grupi i interesit të noterëve kemi paraqitur objeksionet tona në lidhje me ligjin e ri të noterisë që hyri në fuqi në 2019 dhe janë ankimuar ato që ishin deri diku shkelje apo padrejtësi të bëra me dispozitat kushtetuese edhe jam ndjerë shumë lumtur kur këto objeksione janë marrë parasysh të gjitha dhe nga komisioni i ligjeve dhe legjislatori si të thuash patën goxha impakt. Mund të them që për mua Kushtetuta ka qenë si të thuash pjese e tryezës sime. Domethënë në librat e mi të punës Kushtetuta nuk ka munguar asnjëherë. Kështu që deri diku mbase...”

Saida Dollani pyet nëse kandidatja i ka dhënë kontributet në shoqërinë civile duke qenë se ka pasur profesionin e lirë të avokatit dhe më pas funksionin publik të noterit. Jam shume dakord me atë që thatë, që është një para-gjykatë dhe sa më mirë ta bëjë punën noteri aq më pak, sidomos në fushën civile, ka mosmarrëveshje gjykata. Në këtë kontekst, në lidhje me detyrën e noterit a ka pasur ndonjë rast në karrierën tuaj që të jetë kontestuar ndonjë akt përpara gjykatës, në kuptimin e goditjes për falsitet? E bëj këtë pyetje jo për paragjykime, por për të sqaruar pasi pak më parë thatë që është krijuar një mosbesim dhe kjo vjen pikërisht nga hartimi i kontratave jo korrekte e detyrës së noterit kryesisht.

Sonila Bejtja përgjigjet: “Po filloj nga pyetja e dytë, sepse e kam më të kollajshme t’i përgjigjem. Në dijeninë time deri më sot ka pasur vetëm një kontratë të kontestuar në gjykatë, por kjo jo për vërtetësinë e aktit noterial për më tepër sesa mosmarrëveshje të palëve që i janë drejtuar gjykatës. Deri me sot ndihem me fat, por dhe kam punuar për këtë gjë që asnjë kontratë e imja nuk është kundërshtuar apo goditur nga asnjë nga institucionet e drejtësisë për falsifikim, sepse parimi im është se unë dua të punoj që fëmijëve të mi t’ju lë një emër të mirë, që vetes time dhe prindërve të mirë të mos u shkaktoj asnjë trishtim dhe që kur të fle të jem shume e qetë dhe asnjë herë nuk i kam dhënë rendësi këtij lekut të shpejtë që më vonë të kisha pasoja. Kam ecur e qetë, pak dhe saktë, por çfarë e kam bërë e kam bërë me zemër, madje kur kam punuar për noterinë kam sjelle një risi në kontratat tipike, që mbasi shumë noterë nuk i dinin, të gjitha këto i kam bazuar nga e drejta italiane, duke u munduar t’i përshtas, sepse shikoja që ishin kontrata gjysmë faqe që nuk më thoshin asgjë dhe më shkaktonin panik, jam munduar që kontrata të jetë sa më e gjatë sa më e plotë sa më

shtruese, kjo për pjesën e noterisë. Pjesa i përket shoqërisë civile, nuk e kam shume të qartë, çfarë nënkuptoni me shoqëri civile”.

Saida Dollani merr fjalën dhe shprehet se në metodologjinë e pikëzimit përcaktohet, por edhe në vendimin nr.5 përcaktohet se çfarë kupton kjo pjesë shoqëri civile dhe bëhet fjalë për ato kauza që vetë shoqëria civile është ngritur në mbrojtje për një padrejtësi që ajo ka pasur në vëmendjen e saj. P.sh. sjell rastin e një tjetër anëtarit të Gjykatës Kushtetuese që kishte marrë pjesë për mbrojtjen e një kauze.

Sonila Bejtja përgjigjet se më tepër ka pasur të bëjë me detyra ose me impenjime që deri diku kanë sjellë një impakt në shoqërinë shqiptare. Ka pasur edhe ajo qëndrimet e saja publike përpara kandidimit për çështje të nxehta që nuk do donte t'i përmendte tani, se mbase paragjykohet situata. Ka qenë e përfshirë në projekte të mëdha që kanë pasur impakt në shoqërinë shqiptare po nga ana tregtare, si psh privatizimi i Bankës së Kursimeve apo privatizimi i Birra Tiranës, Ujësjellësi apo TAP-i. Të gjitha këto kanë qenë marrëdhënie ku është përfshirë jo në nivel të impenjimit publik por kryesisht privat.

Fatjona Memçaj pyet, në kuptim të një pjese të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, që janë të drejtat në një proces penal, viktimat, të pandehurit, se cili është aktiviteti i kandidatit në këtë fushë dhe së e njeh dhe sa eksperiencë ka pasur në këtë proces.

Sonila Bejtja përgjigjet se procesin penal e njeh nga literatura dhe leximi i kazuseve që mund të ketë pasur në zyrën avokaturës ku ka bërë pjesë, sepse si zyrë ligjore ka pasur mjaft procese ku ka marrë pjesë, qofshin këto edhe penale. Një nga këto ka qenë arrestimi i zonjës K.B. që ishte një nga çështjet më të rëndësishme që zyra merrte pjesë dhe strategjitë diskutoheshin ndër avokatët kryesorë të zyrës, kështu që është hasur edhe me këto specifika të procesit penal. Përveç kësaj, shprehet se lënda më e bukur që ka pasur dhe notën më të lartë në Itali ka qenë procedura penale. Pse nuk e ka ushtruar? Sepse ka pasur një lloj hezitimi dhe një lloj si të thuash sugjestionimi nga pyetjet e miqve, që është goxha e vështirë si fushë dhe për këtë arsye ka zgjedhur të Drejtën Tregtare. Kishte skepticism por kjo nuk do të thotë se si notere nuk e njeh si proces.

Arta Marku kam dy pyetje. Së pari, si e mendon punën si pjesë e një organi kolegjal siç është Gjykata Kushtetuese” Së dyti nëse do jetë e vështirë dhe çfarë opinionit mund të ketë.

Sonila Bejtja përgjigjet se mendon dy janë sfida të rëndësishme për të, e para kjo profesionale dhe e dyta rritja e dy fëmijëve civilë qytetarë. Këto do të jenë dy misionet e saj. Sa i përket sfidës profesionale do jetë një sfidë e vështirë, por mendon se do e ndihmojë puna në grup, një komunikim sa më i mirë i një fryme grupi dhe jo individualiste dhe mbi të gjitha komunikimi dhe këshillimi me të gjithë anëtarët e trupës gjyqësore, me të gjithë anëtarët Gjykatës Kushtetuese, marrja parasysh dhe e opinionëve ligjore të këshilltarëve, sepse janë ata që prekin me dorë vërtet çështjen, dhe mbi të gjitha pastaj studimi i legjislacionit dhe jurisprudencës, krahasimi me legjislacionin e huaj, analogjitë të gjitha këto, por e rëndësishme është puna në grup. Një njeri që nuk punon dot në grup është e kotë se nuk e bën dot këtë lloj pune. Duhet frymë grupi dhe jo individualizmi ndaj kjo është shumë e rëndësishme.

Arta Marku pyet nëse e ka menduar gjatë kësaj periudhe që nga kandidimi deri tani që do të mund të jetë e paragjykuar në punën e saj. Nëse po si mendon, mbi çfarë mase do ndikojë kjo në punë?

Sonila Bejtja përgjigjet: “Sa u përket paragjyqimeve kam përshtypjen që kanë filluar më herët, por unë nuk para i kam dhënë shumë rëndësi, sepse mendoj që paragjykimi është i drejtë atëherë kur ka bazë. Paragjykohet profesioni i avokatit, i noterit, por kjo nuk më ka ndaluar që të vazhdoj përpara me sukses punën time dhe të jem ajo që jam duke lënë mbrapa paragjykimet. Për mua kryesorja është që të mos paragjykoen vendimet, por jo unë si individ, dhe për të mos pasur vendime të paragjykuara është shumë e rëndësishme të qenit

asnjanës, profesionist dhe profesional, kështu që kjo pjesa paragjyqimit nuk më shqetëson nuk përbën për mua asnjë lloj problemi. Kuptohet që impakti i publikut është shumë i rëndësishëm, por unë mendoj se ia kanë arritur dhe persona të tjerë para meje që të jenë më transparentë dhe të mos krijojnë mpakte shumë të rënda publikut. Mendoj që do të ndjek rrugën e tyre” .

Vitore Tusha i drejtohet kandidatës se shpалosi si një nga prioritetet më të rëndësishme rikthimin e besimit për drejtësi, pra për drejtësinë kushtetuese. Edhe pse ndër vite drejtësia kushtetuese ka pasur një vlerësim shumë të mirë mungesa e vendimmarrjes së kësaj Gjykate për gati 3 vjet ka qenë një problem me impakt social dhe më gjerë. Pyet në lidhje me këtë çështje se si dhe me çfarë mjetesh mendon se mund të arrihet rikthimi i besimit?

Sonila Bejtja përgjigjet: “Mendoj se fakti i ngritjes së Gjykatës Kushtetuese në fazat ku jemi përbën në vetvete një gjë shumë të rëndësishme dhe shikoj që dhe qytetarët po fillojnë të profilizojnë idenë se mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, se po e kemi një gjykatë. Kjo është një plus në CV e Gjykatës Kushtetuese dhe në vijimësinë e mëtejshme për sa u përket vendimeve *hot* që vërtet do të kenë impakt të gjerë në publik, por për këto vendime mendoj që Gjykata Kushtetuese do të jetë shumë e kujdesshme dhe të ecë vërtet me hapa të matura për të marrë vendime. Unë mendoj se në momentin që merren vendime duke u bazuar në legjislacion pa pasur parasysh interesat e palëve dhe pa i marrë parasysh se njëra palë kërkon këtë dhe unë profilizohem me këtë pale, jo. Mendoj që në momentin që ti ke legjislacionin përpara interpreton në mënyrë korrekte, intuita jote prej juristi të thotë se duhet bërë kështu. Fakti që komunikon me kolegët merr një frymë grupi, shikon cila është tendenca e grupit gjykues, mendoj që edhe në rast se duhet të isha në oponencë ose në minorancë, mjafton që unë të arsyetoja në mënyrë ligjore të saktë kjo nuk do të përbente për mua një cen në CV, sepse nga ana ligjore do të shikohej dhe arsyetimi im, do të qëndronte apo jo, edhe për sa u përket çështjeve të tjera që janë më poshtë, mendoj që marrja në shqyrtim sa më shpejt brenda të gjitha afateve domethënë respektimi i afateve ligjore, dhënia e vendimeve në mënyrë shteruese, kjo te qytetari të lërë një shije të mirë, paçka se ne të drejtën për t’u ankimuar nuk ia heqim dot askujt, por në rast se shkon dhe ankimohet në Strasburg dhe ia i jep të drejtën Gjykatës Kushtetuese, atëherë unë mendoj se është një fitore në vetvete, prandaj dhe unë mendoj të platforma ime. Synimi im është sa më pak çështje të kthyera mbrapsht dhe sukcesi duhet të jetë i garantuar”.

Vitore Tusha përfundon intervistën e Këshillit me kandidaten dhe vijohet me pyetjet dhe me pjesën e intervistës që do të bëjë ekspertja znj. Adelina Albrahimi.

Ekspertja përkthye zhvillon bisedën e lirë me pyetje-përgjigje me kandidaten Sonila Bejtja në gjuhën angleze (kohëzgjatja e kësaj pjese të intervistës rreth 5 minuta)

Vitore Tusha falënderon kandidaten, duke e konsideruar të mbyllur intervistën e zonjës Sonila Bejtja.

Fton anëtarët të tërhiqen për vendimmarrje për zotin Binaj dhe më pas për çështjen tjetër.

Ndërpritet mbledhja për të rifilluar në orën 13:30.

Vitore Tusha vijon mbledhjen dhe vëren që në këtë pjesë të dytë të mbledhjes nuk është Avokatja e Popullit, por është përfaqësuesi i saj zoti Enio Haxhimihali, po ashtu është përfaqësuesi i Presidentit të Republikës dhe janë anëtarët e Këshillit sipas prezencës së mbledhjes që vijuan më parë.

Këshilli ndërkohë ka marrë vendimet në lidhje me ndërprerjen e procedurës për z Binaj, po ashtu dhe në lidhje me pikëzimin për kandidatin e lejuar zonjës Sonila Bejtja. Thekson se: “Sipas rendit të ditës ne jemi në momentin procedural që duhet të diskutojmë dhe të miratojmë listën përfundimtare të renditjes. Sa kohë që kemi një kandidat të lejuar dhe organi i emërtesës ka shprehur prej kohësh qëndrimin e tij që ne të përcjellim të gjithë kandidatët që do të kemi të lejuar, ju ftoj që të vijojmë me miratimin e listës përfundimtare të renditjes. Ka ndonjë diskutim në lidhje me këtë çështje”?

Bledar Dervishaj merr fjalën: “Si përfaqësues i Presidentit të Republikës, organ emërtese për këtë vakancë, vullneti është i pandryshuar, ashtu siç është bërë me dije me shkresë dhe përmes qëndrimeve tona këtu në mbledhje si përfaqësues të Presidentit, këshilli të vijojë me procedurat e renditjes, miratimit të raportit përmbledhës dhe përcjelljen e listës tek organi i emërtesës, Presidentit të Republikës.”

Enio Haxhimihali shprehet se nuk kanë komente apo pyetje në këtë moment.

Anëtarët miratojnë listën.

Vitore Tusha vijon me procedurën për miratimin e raportit përkatës. Thekson se relatorja e ka përgatitur një raport që lidhet me gjithë procedurën që është ndjekur për këtë vakancë dhe që ka përshkruar të gjitha aktet procedurale për secilin nga kandidatët edhe për përmbylljen, duke përfshirë edhe përmbylljen e kësaj procedure.

I jap fjalën zonjës Miranda nëse ka diçka për të thënë dhe sqaron se raporti u është shpërndarë të gjithëve me *e-mail*, pra kanë dijeni.

Miranda Andoni shprehet se në cilësinë e relatores nuk ka gjë për të shtuar dhe se i qëndron raportit për sa është parashtruar dhe me atë përmbajtje që është paraqitur”.

Vitore Tusha fton anëtarët ta miratojnë nëse nuk kanë pyetje apo ndonjë koment në lidhje me raportin.

Anëtarët miratojnë raportin.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe shprehet se në lidhje me raportin nuk ka gjë dhe se janë në pritje të listës së kandidatëve dhe dokumenteve të tjera njësoj siç Këshilli ka vepruar dhe në praktikën e dy vakancave të tjera, për zotin Binaj që iu përcoll dhe u zgjodh nga Kuvendi, ashtu dhe për zoti Kalo dhe zoti Toma që iu përcollën Presidentit.

Vitore Tusha shprehet se Këshilli miratoi të gjitha aktet që lidhen me përfundimin e procedurave për këtë vakancë, aktin konkret që lidhet me vendimin, me pikëzimet, po ashtu listën përfundimtare dhe raportin përkatës që do i përcillet organit të emërtesës brenda ditës.

Deklaron të mbyllur mbledhjen.

Mbyllet mbledhja në orën 14.26

Tiranë, më datë 28.12.2020

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHA